

SVJETLLANA TITINI

**SHPREHJET JURIDIKE LATINE DHE SHKURTESAT
NË TERMINOLOGJINË E SË DREJTËS NË SHQIPE**

I. Në fushën e leksikut të së drejtës, një grup më vete përbëjnë edhe termat e shprehjet juridike latine. Në këtë gjuhë u përpunua, duke u nisur nga shekulli III p. e. s, sistemi më i përparuar i së drejtës i mbështetur në pronën e thjeshtë private. Tradita romane u shërbeu si themel për ndërtimin e së drejtës që gjen zbatim sot në Europën kontinentale dhe në një pjesë të mirë në kontinentet e tjera. Kjo shpjegon praninë e këtyre termave e shprehjeve jo vetëm në degë të veçanta si e drejta romake që studion historikun e evolucionit të koncepteve dhe institucioneve të së drejtës në Romën e lashtë nga lindja deri në shuarjen e tyre, por edhe në degë të tilla si: e drejta civile, e drejta ndërkombëtare, e drejta e krahasuar apo dhe në praktikën juridike.

a. Siç dihet termi përbën njësinë themelore të komunikimit special. Në fushën e së drejtës përdorimi i termave latine ka dy arsye: për të emërtuar nocione e institucione karakteristike që i përkasin epokës së lulëzimit të së drejtës romake dhe për shkak të karakterit të tyre ndërkombëtar¹. Termave latine u është bërë vend në të dy fjalorët terminologjikë të botuar në fushën e së drejtës. Në Fjalorin e së drejtës ndërkombëtare (1972) përfshihen terma të tilla si: *pactum de contrahendo*, *postliminium*, *res communis*, *res nullius*, *jus belli*, *jus sanguinis*, *jus solis*, *comitas gentium*, *persona non grata*, *sponsio*, kurse në Fjalorin e së drejtës (1986) ka terma të tilla si: *ab intestat*, *animus domini*, *animus possidendi*, *error facti*, *error in corpore*, *error juris*, *error in negotio*, *onus probandi*, *possessio*, *ratio juris*, *ratio legis*, *res nullius*, *quorum*, *lucrum cessans*, *jus scriptum*, *jus non scriptum*, *damnum emergens*, *usucapio*, *vis major*, *casus major*, *corpus delicti*, *casus* etj.

Por duhet vënë në dukje se numri i termave latine të pasqyruara në dy fjalorët e mësipërm është shumë i kufizuar në raport me numrin e termave që ndeshen në letërsinë tonë juridike, të kësaj periudhe. Arsyet,

¹ F. Leka, "Huazime dhe ndërkombëtarizma në terminologjinë tonë teknike- shkencore, *Studime filologjike*, 2, 1986, f. 74.

pse hartuesit e fjalorëve kanë bërë një zgjedhje të tillë, mund të jenë diktuar në radhë të parë nga qëllimi i këtyre fjalorëve për të qenë pasqyrë e një terminologjie të njësuar, të saktësuar e të pasuruar në fushën e së drejtës, por edhe nga vëllimi i fjalorëve dhe nevoja për të ruajtur një përpjesëtim të caktuar midis termave të përfshirë në ta.

Numri i termave latine në letërsinë tonë juridike është shtuar pas viteve 90. Përdorimi i tyre në rritje mund të shpjegohet deri diku me shtimin e degëve të reja të së drejtës, me formimin profesional, të të rinjve shqiptarë në universitetet europiane (kryesisht italiane), por edhe me një rikthim të vrullshëm në përdorim të mjaft termave latine që e kanë barasvlerësin në shqip. Ndër termat latine që ndeshim kohët e fundit janë: *corpus juris*, *ex post facto*, *jus dicere*, *jus cogens*, *jus dare*, *lex mercatoria*, *causa pretendi*, *ratio decidendi*, *iter legis*, *visa abrogans*, *lex Rhodia*, *jus comune*, *deditio*, *obiter dictum*, *brevis*, *opinio* etj.

Emërtimet në latinisht përbëjnë shtresën e huazimeve të paanshme të terminologjisë të së drejtës meqenëse nuk vijnë nga asnjë prej gjuhëve që fliten sot në botë, veç të tjerash ato ruajnë formën tingullore pa iu përshtatur sistemit fonetik të gjuhëve marrëse. Disa terma latine janë zëvendësuar nga terma në shqip p.sh. *persona non grata*- person i padëshirueshëm, *comitas gentium*- mirësjellje ndërkombëtare, *vis major*- forcë madhore, *onus probandi*- barra e provës, *usucapio*- parashkrim vetësues, *corpus delicti*- trupi i krimit, *lucrum cessans*- fitim i munguar, *damnum emergens*- dëm i pësuar, *jus civile*- e drejtë civile, *jus naturale*- e drejtë natyrore, *jus publicum*- e drejtë publike etj. Ndër termat latine, një pjesë edhe pse janë shqipëruar vazhdojnë të përdoren krahas termit shqip ose në vend të tij meqenëse përdoren në latinisht edhe në praktikën botërore p.sh. *jus sanguinis*, *jus soli*, *jus belli*, *persona grata*, *persona non grata* etj.

Një pjesë e termave latine janë terma ndërkombëtarë e si tillë përdoren, kështu, edhe në gjuhët e tjera: *quorum*, *post liminium*, *sponsio* etj., kurse një pjesë tjetër nuk mund të shqipërohen sepse emërtojnë nocione për të cilat në gjuhën tonë nuk mund të gjendet një barasvlerës p.sh. *confaerratio*, *coemptio*, *usus*, *adrogatio*, *difareatio* *adgnatio*, *cognate* etj.

Nga ky këndvështrim shqipërimi i termave latine mbart rrezikun e të shprehurit të nocionit të përafërt apo të pasaktë². Megjithatë vështirësitë e përmendura nuk mund të përlligjin përdorimin e pavend të leksikut me prejardhje nga latinishtja. Jo rrallë ndodh që përdorimi i tepruar i latinishtes, në publikime shkencore e tekste mësimore e në ndonjë rast edhe në sallat e gjyqit e bëjnë gjuhën juridike një kod edhe më të vështirë për t'u kuptuar nga të gjithë.

b. Në fjalorët e së drejtës janë pasqyruar krahas termave latine edhe shprehjet juridike latine. Pjesa më e madhe e këtyre shprehjeve është zëvendësuar me shprehje në shqip, ndërkohë që një pjesë tjetër, meqenëse hasen dendur në praktikën ndërkombëtare vazhdojnë të përdoren në latinisht p.sh. *stare decisis, ipso facto, ipso jure, de facto, de jure, rebus sic stantibus, pacta sunt servanda, ad interim, sub spe rati, uti possidetis* etj.

Disa shprehje latine që nuk janë karakteristike për fushën e së drejtës (por i hasim në përdorim në disa fusha e më gjerë në komunikimin e përgjithshëm) janë përfshirë në fjalorët terminologjikë të së drejtës për shpresinë me të cilën përdoren në fushën e së drejtës.

Si përfundim mund të themi se këta fjalorë, ndonëse të botuar në një periudhë kohore jo shumë të afërt, kanë shërbyer deri më sot për të lehtësuar në një farë mase njohjen dhe përdorimin e termave e shprehjeve latine nga cilido që studion për drejtësi apo ushtron profesione të tjera për të cilat është e nevojshme njohja e së drejtës dhe e rregullave të saj. Në këto kushte do të ishte e dobishme që në fjalorin e ri terminologjik të së drejtës t'i kushtohet një hapësirë më e gjerë, se në ata pararendës, leksikut me prejardhje nga latinishtja e pse jo, në të ardhmen të hartohet një fjalor më vete që do të ishte një ndihmë konkrete për studentët meqenëse në procesin e formimit parauniversitar nuk parashikohet mësimi i gjuhës latine dhe fjalorët terminologjikë të së drejtës që ekzistojnë përmbajnë një numër shumë të vogël termash e shprehjesh juridike latine në raport me numrin e atyre që përdoren realisht në letërsinë tonë juridike.

II. Shkurtesat janë një mjet ndihmës që mbështet leksikun e së drejtës³. Ato emërtojnë institucione e organizma kombëtare e

² F. Leka, "Aspekte të zhvillimit të terminologjisë tekniko- shkencore pas Çlirimit", *Studime filologjike*, 1, 1970, f. 108-109.

³ *Gramatika e gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencës e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1995, f. 74-75.

ndërkombëtare dhe marrëveshje të nënshkruara në kuadër të bashkëpunimit me to. Në këto tetëmbëdhjetë vitet e fundit është shtuar shumë numri i shkurtesave meqenëse është rritur edhe prania e institucioneve e organizmave që veprojnë në vendin tonë apo me të cilat janë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi. Në këndvështrim analitik shkurtesat mund të klasifikohen në dy grupe: shkurtesa të huaja e shkurtesa shqipe.

Shkurtesat e grupit të parë në pjesën e tyre më të madhe mund të thuhet se kanë karakter ndërkombëtar duke qenë se përdoren kështu në të gjitha gjuhët, e ndonjë tjetër përdoret në gjuhë të huaj ndonëse nuk ka karakter ndërkombëtar⁴. P.sh. Nga grupi i shkurtesave me karakter ndërkombëtar: FAO, UNCITRAL, NATO, EFTA, GATT, UNESCO, ODHIR, BIRD, FAO, OIT etj., nga grupi i shkurtesave me karakter jondërkombëtar: AIEA, PNUD etj. Shumë shkurtesa të huaja janë zëvendësuar me përgjegjëset në shqip p.sh. BEL, FMN, OKB, BE, OSBE, BERZH, OBT, MSA, DHTN, GJND, KESH, KTZH etj. Është vënë re gjithashtu rikthimi në përdorim i shkurtesave të huaja megjithëse ekzistojnë përgjegjëset në shqip: FAO për OUB, AIEA për ANEA, PNUD për PKBZH etj.

Në fushën e së drejtës shkurtesat në gjuhën shqipe emërtojnë kryesisht institucione si: KLD, KQZ, KZQV, KZZ, KM, GJK, MASH, MTKRS, MPPTT, MSH, MD, ILDKP, KLSH, por edhe nocione të tjera si: VKM, KF, KC, KP, KPC, KLD, KSK, FA, ZEE etj.

Përdorimi në rritje i shkurtesave, kohët e fundit është bërë një dukuri mjaft shqetësuese në gjuhën shqipe. Për më tepër ajo ka shtrirë ndikimin e vet edhe në terminologjinë e fushave të caktuara siç e dëshmojnë edhe shembujt e mësipërm nga terminologjia e së drejtës. Prirja për të zëvendësuar emërtimet me shkurtesat e tyre vështirësojnë komunikimin sepse: a- bëjnë informacionin të padeshifrueshëm (numri i madh e vazhdimisht në rritje i shkurtesave e bën të pamundur të kujtosh se cilave emërtime u referohen), b- shpesh çojnë në keqkuptime meqenëse e njëjta shkurtesë emërton institucione apo nocione të ndryshme p.sh.: KLD (Këshilli i Lartë i Drejtësisë)- KLD (Kanuni i Lekë Dukagjinit), TVSh (Televizioni Publik Shqiptar)- TVSh (Tatim mbi vlerën e shtuar), KESH (Këshilli Ekonomik i OKB-së)- KESH

⁴ H. Pasho, “Fjalët e huaja në gjuhën letrare shqipe”, *Studime filologjike*, 1-2, 1999, f. 93-94.

(Korporata Energjitike Shqiptare) etj. Përballë një situatë të tillë del e domosdoshme mënjanimi i shkurtesave që e ngarkojnë gjuhën në mënyrë të panevojshme duke u bërë pengesë serioze për një komunikim që u përgjigjet kërkesave të qartësisë e rrjedhshmërisë.

SUMMARY

THE LATIN JURIDICAL EXPRESSIONS AND THE ABBREVIATIONS IN THE TERMINOLOGY OF LAW IN ALBANIAN

I. The terms and expressions of Latin origin which have been reflected in two terminological dictionaries on the field of law, already published, constitute a group of their own within the area of the lexicon of law.

There are two reasons that support the use of the Latin terms in the field of law: in order to refer to characteristic institutions that belong to the period of the raise of the Roman law and because of their international character.

A certain part of the Latin terms are international ones, and being such, they are used in other languages. There are also other terms that are often used in Latin even though they have already been replaced by Albanian terms.

II. Abbreviations as an auxiliary mean that supports the lexicon of law refer to international institutions and signed pacts in the context of the collaboration with them. Basing on an analytic viewpoint, the abbreviations can be classified in two groups: Foreign abbreviations and Albanian ones.

The tendency that has been noticed lately, the one that tends to replace the references with their abbreviations, influence by making the communication more difficult.

As we find our selves in front of this situation it becomes crucial to avoid abbreviations that throw a useless weight on the system of language, becoming in such a way a serious obstacle for a clear and fluent communication.

